



Periodik mujor Nr. 170 Korrik 2023

**Në
këtë
periodik
do të lexoni:**

**Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së
raporton në Kuvendin e Shqipërisë**

**VËSHTRIM
MBI TREGJET**

2023

Tregu i Sigurimeve, Janar- Qershor 2023

5

ZHVILLIME TË TJERA

**BOTIME
PROFESIONALE**

6-11

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

12-13

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së raporton në Kuvendin e Shqipërisë



Tiranë, 20 korrik 2023 – Raportimi në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2022

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete prezantoi sot, më 20 korrik 2023, në seancë plenare në Kuvendin e Shqipërisë, raportin mbi veprimtarinë e Autoritetit gjatë vitit 2022. Z. Mete bëri një pasqyrim të zhvillimeve kryesore përgjatë vitit të kaluar, ecurisë së tregjeve nën mbikëqyrje, si edhe paraqiti objektivat kryesore për periudhën në vazhdim.

Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi se viti 2022 ka pasur një sërë zhvillimesh të rëndësishme në tregjet financiare jobankare, si edhe në procesin e negociatave me Bashkimin Evropian. Pavarësisht ndikimeve në segmente të caktuara të tregjeve nën mbikëqyrje gjatë vitit të kaluar, për shkak të presioneve inflacioniste, aktualisht këto tregje shfaqen të qëndrueshëm dhe i janë rikthyer trendit rritës.

Tregu i sigurimeve vijoi konsolidimin e treguesve, rritje të primeve të shkruara bruto dhe rritje të dëmeve të paguara në numër e në vlerë. Raporti i numrit të dëmeve pezull kundrejt totalit të dëmeve të raportuara në tregun e Jo-Jetës zbriti në nivelin më të ulët historik.

Ligji i ri për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit ka dhënë impakt të konsiderueshëm në treg, duke sjellë uljen e shpenzimeve të marrjes në sigurim, reduktimin e praktikave të mbartura të Fondit të Kompensimit, ku ndikim pati edhe aplikimi i siguruesit të drejtpërdrejtë, si edhe përdorimin e Raportit Evropian të Aksidenteve. Ndërhyrjet ligjore sollën gjithashtu përmirësim të ndjeshëm të situatës me Byronë Shqiptare të Sigurimit, e cila doli nga monitorimi thuajse 10-vjeçar i Këshillit të Byrove.

Vijon ...

Raporti Vjetor 2022

publikuar gjendet në:

https://amf.gov.al/pdf/publikime2/raport/RV2022-31_032022final.pdf

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së raporton në Kuvendin e Shqipërisë

... vijon

Në tregjet e kapitalit, subjektet përfunduan procesin e përshtatshmërisë me kërkesat e ligjit të ri, si edhe zgjeruan licencat, duke diversifikuar shërbimet e investimit dhe instrumentet financiare të ofruara për investitorët. U plotësua më tej baza ligjore e nënligjore dhe infrastruktura e tregjeve të kapitalit. Bordi i Autoritetit miratoi prospektin e parë të një shoqërie tregtare për emetim obligacionesh me ofertë publike.

Z. Mete u shpreh se viti i kaluar solli avancime të rëndësishme ligjore e rregullatore dhe Autoriteti mori vlerësime nga Komisioni Evropian sa i përket harmonizimit të legjislacionit me acquis e BE-së. Gjithashtu, Autoriteti shënoi përparim domethënës në vlerësimin e bërë nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS). Në raportin përfundimtar, rezultoi një nivel i lartë përputhshmërie, ku nga 24 Parime Themelore Bazë, 10 u vlerësuan plotësisht të përputhura me parimet ndërkombëtare dhe 12 të tjera të përputhura gjerësisht.

IAIS vlerësoi se “AMF ka ndërmarrë reforma të gjithanshme gjatë viteve të fundit, duke forcuar ligjin kuadër, si edhe rishikuar ligjet dhe rregulloret në tregun e sigurimeve. Progresi është udhëhequr nga objektivi i përafrimit me kërkesat e BE-së. Aktiviteti rregullator karakterizohet nga objektiva të qarta dhe pavarësi institucionale, ekziston një kuadër ligjor i zhvilluar për licencimin, veprimet e tjera rregullatore, kërkesat për përshtatshmëri, mirëqeverisjen dhe menaxhimin e riskut, përfshirë risqet e lidhura me risigurimin.”

Në fund të fjalës së tij, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi se Autoriteti, në mbështetje të Strategjisë 2023-2027, do të vijojë të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, vijimin e procesit të përafrimit të akteve ligjore e nënligjore me direktivat evropiane, mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit përmes rritjes së kërkesave për transparencë dhe informacion nga subjektet e mbikëqyrura, zhvillimin e financimit të gjelbër, si edhe thellimin e proceseve të digjitalizimit dhe përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Autoriteti do të vijojë të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, vijimin e procesit të përafrimit të akteve ligjore e nënligjore me direktivat evropiane

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar – Qershor 2023


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajit janar-qershor 2023 kapën vlerën 11,042 milionë lekë, ose 12.96% më shumë se në periudhën janar-qershor 2022. Gjatë muajit janar-qershor 2023, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 638,072 me një rritje prej 12.72% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.80% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, sigurimet e Jetës kanë 8.13% dhe risigurimi 0.07 %. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 45.05% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 54.95% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-qershor 2023, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 3,312 milionë lekë, ose 3.54% më shumë se në muajin janar-qershor 2022.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin e motorik për muajin janar-qershor 2023 kapën vlerën 3,159 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 4.04% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar – Qershor 2023 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar-qershor 2023 arritën rreth 6,067 milionë lekë, ose 7.54% më shumë se në muajin janar-qershor 2022

ZHVILLIME TË TJERA

AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren “Për licencimin e agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe njohjen e një agjencie të huaj të vlerësimit të rrezikut të kreditit”



Projektrregullorja gjendet në faqen zyrtare të Autoritetit, në linkun <https://amf.gov.al/projekt.asp?id=94>

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në zbatim të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 "Për Tregjet e Kapitalit", ka hartuar me asistencë të huaj dhe mbështetje të Bankës Botërore projektregulloren për “Për licencimin e agjencisë së vlerësimit të rrezikut të kreditit dhe njohjen e një agjencie të huaj të vlerësimit të rrezikut të kreditit”. Projektrregullorja publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik.

Publikohet raporti i IAIS mbi vlerësimin e Parimeve Themelore në Sigurime për AMF



Publikohet në faqen zyrtare të internetit raporti i plotë i vlerësimin të realizuar nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS) për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, në lidhje me përputhshmërinë me Parimet Themelore në Sigurime (ICP).

Gjatë vitit 2022, Autoriteti iu nënshtrua një procesi rigoroz vlerësimi në lidhje me përputhshmërinë e standardeve dhe praktikave të AMF-së me Parimet Themelore në Sigurime (ICP).

Procesi i vlerësimin të përputhshmërisë me ICP-të u krye nga anëtarë të IAIS-it, bazuar në Programin e Vlerësimin të Anëtarit dhe përfshiu aspektin ligjor e rregullator, pavarësinë institucionale, procedurat e licencimit, praktikat mbikëqyrëse dhe ato të vlerësimin të rrezikut, mbikëqyrjen e grupeve të sigurimit, etj. Raporti përfundimtar i vlerësimin u miratua nga Komiteti Ekzekutiv i IAIS në Takimet e Komiteteve dhe Seminari Global i IAIS, në muajin qershor në Siatëll, SHBA.

Në raportin e përgatitur nga Grupi i Vlerësimin të IAIS-it rezultoi një nivel i lartë i përputhshmërisë me ICP-të, ku nga 24 parime bazë, 10 prej tyre rezultuan plotësisht të përputhura dhe 12 të tjera me një nivel të lartë përputhshmërie. Ky vlerësim përbën një avancim të ndjeshëm kundrejt rezultateve të vlerësimin të bërë në kuadër të Programit të Vlerësimin të Sistemit Financiar (FSAP) në vitin 2014, realizuar nga Banka Botërore dhe FMN.

Raporti i publikuar gjendet në <https://www.iaisweb.org/2023/07/detailed-assessment-of-observance-of-the-iais-insurance-core-principles-in-albania/>

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së në ceremoninë e listimit të instrumentit të parë në Bursën ALSE



Tiranë, 5 korrik 2023 - Ceremonia e listimit të instrumentit të parë joqeveritar në Bursën Shqiptare të Titujve, ALSE

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete, mori pjesë në ceremoninë e listimit të instrumentit të parë në Bursën Shqiptare të Titujve, ALSE, nga ana e një kompanie private. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin Ministrija e Financave dhe Ekonomisë, zj. Delina Ibrahimaj, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, Drejtoresha e Përgjithshme e Bursës ALSE, zj. Nada Vokshi, drejtues të shoqërive që operojnë në tregjet financiare, si edhe përfaqësues të bizneseve.

Në fjalën e tij, z. Mete theksoi se janë dashur jo pak përpjekje për të arritur deri këtu, ndërsa uroi që ky hap të shërbejë si shembull për t'u ndjekur nga kompani të tjera, publike ose private.

Ligjet e reja për tregjet e kapitalit dhe për sipërmarrjet e investimeve kolektive sjellin harmonizim me kuadrin ligjor të BE, vendosin standarde evropiane për veprimtarinë e subjekteve nën mbikëqyrje, si edhe rrisin standardet e mbikëqyrjes.

Ligji i ri për fondet e investimit na krijon mundësinë të sillemi si rregullatorë evropianë, edhe pse nuk jemi ende në BE. Kemi lidhur së fundmi marrëveshje me vende të zhvilluara në këtë drejtim, siç është Austria dhe Luksemburgu, ndërkohë që emra të mëdhenj evropianë sa i përket fondeve të investimit kanë shfaqur interes për të operuar në Shqipëri. Aktualisht, kemi një aplikim nga një prej fondeve më të mëdha në Evropë për të qenë i pranishëm në Shqipëri, si edhe një tjetër aplikim nga një fond evropian për të krijuar fondin e parë të gjelbër ESG në vendin tonë – u shpreh z. Mete.

vijon ...

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv z. Ervin Mete theksoi se janë dashur jo pak përpjekje për të arritur deri në listimin e instrumentit të parë në Bursën Shqiptare të Titujve dhe uroi që ky hap të shërbejë si shembull për t'u ndjekur nga kompani të tjera, publike ose private

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së në ceremoninë e listimit të instrumentit të parë në Bursën ALSE



Tiranë, 5 korrik 2023 - Ceremonia e listimit të instrumentit të parë joqeveritar në Bursën Shqiptare të Titujve, ALSE

... vijon

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së deklaroi se të gjitha bankat që operojnë në tregjet e kapitalit duke kryer shërbime investimi për klientët, kanë realizuar procesin e përshtatshmërisë, kanë zgjeruar licencat e tyre bazuar në ligjin e ri dhe tashmë operojnë në një format rregullator evropian.

Për të gjitha këto, Autoriteti mori vlerësime nga Komisioni Evropian në shkurt të këtij viti në Takimet Bilaterale në Bruksel për kapitullin 9, ku u konstatua progres i konsiderueshëm në procesin e përafrimit ligjor e rregullator me *acquis* dhe direktivat evropiane. Gjithashtu, për shkak të avancimit të bërë me bazën ligjore e rregullatore për tregjet e kapitalit, Banka Botërore ka përzgjedhur dhe ka rekomanduar Autoritetin që të asistojë Komisionin e Letrave me Vlerë të Ukrainës, në procesin e nisur prej tyre për të harmonizuar kuadrin ligjor me praktikën dhe direktivat evropiane.



Si mundet që dixhitalizimi ta bëjë më të lehtë dhe më efikate mbikëqyrjen e planeve të pensioneve?

Nina Paklina
Korrik, 2023

Ky raport është pjesë e punës së IOPS-it për dixhitalizimin. Ai synon të mbledhë dhe të ndajë përvojat në lidhje me zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive inovative (SupTech) nga mbikëqyrësit e pensioneve për të përmirësuar dhe mbështetur praktikën dhe proceset mbikëqyrëse. Raporti synon gjithashtu të identifikojë zhvillime të reja dhe fushat me interes të veçantë për sektorin privat të pensioneve. Gjetjet kryesore janë nxjerrë kryesisht nga përgjigjet e anëtarëve në sondazhin e IOPS-it me temën “Si mund ta bëjë dixhitalizimi më të lehtë dhe më efikate mbikëqyrjen e planeve të pensioneve?” Autoritetet nga 38 juridiksione të anëtarëve të IOPS morën pjesë në anketim.

Raporti rishikon përshtatjen e teknologjive mbikëqyrëse (si p.sh. *machine learning*, *natural language processing*, *artificial intelligence (AI)*, *cloud computing*) dhe fushat e mbikëqyrjes financiare në të cilat përdorin këto teknologji inovative, duke përfshirë mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave, analizën e të dhënave mbikëqyrëse, monitorimin mbikëqyrës, komunikimin dixhital, mbrojtjen e konsumatorëve, etj. Raporti përmban gjithashtu disa shembuj të iniciativave specifike për pensionet private, si ndërtimi i një platforme të vetme dhe të integruar dixhitale (p.sh. Platforma eMPF, Hong Kong, Kinë) për të standardizuar, thjeshtuar dhe automatizuar proceset ekzistuese të administrimit të skemave të pensioneve. Kjo do të duhet të rrisë efikasitetin e funksionimit të skemave të pensioneve, administrimin, cilësinë e shërbimeve të pensioneve dhe të mundësojë arritjen e kursimeve të kostos për skemat dhe anëtarët e pensioneve.

Vijon ...

Si mundet që dixhitalizimi ta bëjë më të lehtë dhe më efikate mbikëqyrjen e planeve të pensioneve?

... vijon



Infomacioni gjendet në:
<https://www.iopsweb.org/WP%2040%20IOPS%20SupTech%20report.pdf>

Raporti përfshin pikëpamjet mbikëqyrëse dhe vlerësimin mbi sfidat kryesore të zbatimit (të tilla si kapacitetet dhe aftësitë mbikëqyrëse për të përdorur mjetet aktuale dhe të ardhshme SupTech, burimet, cilësinë e të dhënave, integrimin e mjeteve të reja në rrjedhën e punës dhe infrastrukturën ekzistuese të TI-së, ligjore, operacionale, duke përfshirë kibernetikën çështjet e sigurisë, etj.) në procesin e miratimit të mjeteve SupTech.

Së fundi, raporti ofron njohuri dhe gjetje kryesore nga fazat e zhvillimit dhe zbatimit të adoptimit të teknologjisë inovative SupTech në punën e përditshme mbikëqyrëse në fushën e pensioneve private. Kjo mund të shërbejë si përvojë e mire midis autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve.

MOLDAVI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga autoriteti rregullator “Komisioni Kombëtar i Tregut Financiar”, tregu i sigurimeve të Moldavisë e mbylli tremujorin e parë 2023 me një rritje të primeve të shkruara bruto prej 44.10%, e shprehur në terma vjetorë, duke arritur në 664.24 milionë MDL, ose rreth 33.17 milionë euro.

Dëmet e paguara të siguruesve vendas u rritën me 26.90% duke arritur në 234.77 milionë MDL ose rreth 11.72 milionë euro.

Tregu mbetet i dominuar nga sigurimet e Jo-Jetës, të cilat zënë mbi 96% të tregut. Megjithatë, vlen të përmendet rritja shumë e shpejtë e sigurimeve të Jetës, të cilat në krahasim me tremujorin e parë të 2022 u rritën me 742.71%. Sigurimi i Jetës arriti në 25.52 milionë MDL, përkundrajt 3.03 milionë MDL që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në sigurimet e Jo-Jetës, vëllimin më të madh të primeve e zinte sigurimi motorik me rreth 66% të të gjitha primeve të shkruara bruto të tregut. Sigurimet e Jo-Jetës në tërësi u rritën me 35%.

Dëmtimet e paguara sipas klasave shënuan rritje pothuajse kudo, me përjashtim të sigurimit kundër zjarrit dhe rreziqeve të tjera shtesë, të cilat ranë me -75.65%.

Në fund të tremujorit të parë të vitit 2023, në tregun e sigurimeve në Moldavi operonin 9 sigurues.

POLONI

www.xprimm.com

Sipas botimit “Gazeta Ubezpieczeniowa”, mbështetur në të dhënat e Rankomat, në Poloni, siguruesit regjistruan një tjetër ulje të çmimit të MTPL, në fund të gjysmës së parë të 2023. Primi mesatar i sigurimit MTPL u ul me 4.2% në terma vjetorë dhe arriti në 502 PLN ose rreth 113 euro. Megjithatë, vlen të theksohet se gjatë tremujorit e dytë u vu re rritje e çmimeve në të gjithë tregun e sigurimeve. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2023, në tremujorin e dytë, primi mesatar u rrit me 5.3%, duke treguar një ndryshim të tendencave të primit mesatar.

"Gjatë tre muajve të fundit, primi mesatar i detyrimeve ndaj palëve të treta, MTPL, u rrit me 5.3% krahasuar me tremujorin e parë të 2023. Kjo është rritja e parë e rëndësishme në çmimin mesatar të sigurimit të detyrueshëm që nga viti 2017. Tremujori i parë i këtij viti mund të jetë pra periudha e fundit në të cilën pronarët e makinave gëzonin çmime të ulëta policore", komentoi Tomasz Masajlo, President i Bordit Menaxhues të Rankomat.

RUMANI

www.xprimm.com

Siguruesit rumunë, për tremujorin e parë 2023, raportuan një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 957.9 milionë euro, që është vetëm 1.74% më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Nga ky vëllim total, sigurimet e Jetës zënë 16.75% të primeve të shkruara bruto. Ky vëllim primesh është 0.7% më pak se një vit më parë ose i shprehur në vlerë absolute rreth 160.4 milionë euro. Sigurimet e Jo-Jetës patën një normë pozitive rritjeje prej 2.24% duke arritur në 797.5 milionë euro, që është një evolucion mjaft modest, pas rezultateve të vitit 2022.

Sigurimi i pronës shënoi një evolucion të dukshëm dhe primet u rritën me 20%, duke arritur në rreth 107 milionë euro. Sigurimet motorike regjistruan në përgjithësi një rënie prej 3.3% të vëllimit të primeve dhe klasa e sigurimeve MTPL kishte një tendencë negative.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto të sigurimit MTPL arriti në rreth 440 milionë euro, me një rënie prej 8.11% në terma vjetorë. Megjithatë, duhet mbajtur parasysh se, krahasuar me një vit më parë, numri i siguruesve të licencuar për të ofruar sigurime MTPL ka rënë në gjashtë shoqëri: Allianz-Tiriac, Asirom-VIG, Generali Romania, Grawe Romania, Groupama dhe Omnisig-VIG, ndërkohë që ish-lideri i tregut për sigurimin MTPL, Euroins, ka humbur të drejtën për të kryer veprimtari sigurimesh që nga mesi i marsit 2023. Në treg ekzistojnë dy ofrues të tjerë të sigurimit MTPL, që operojnë në FoE, Axeria IARD dhe Hellas Direct.

Sipas të dhënave të autoritetit rregullator të tregut në Rumani, numri i kontratave MTPL (të përvitshme) të shitura në tremujorin e parë 2023 ishte rreth 11% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Për të njëjtën periudhë, dëmet e paguara për sigurimin MTPL u rritën me 35%, të nxitura kryesisht nga inflacioni. Gjithashtu, Fondi i Garancisë miratoi pagesat e dëmeve për MTPL me vlerë rreth 30.6 milionë euro, që e çon totalin afër 240 milionë euro.



Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al